



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GRACANICA

Numri i lëndës: 2024:324061  
Datë: 26.11.2024  
Numri i dokumentit: 06511889

**K.nr.394/2024**

**GJYKATA - THEMELORE – PRISHTINË/DEGA NË GRAQANICË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES**, sipas Gjyqtarit Rrustem Begolli, me pjesëmarrjen e Zyrtarës ligjore Blerta Bekteshi, në lëndën e kundërvajtjes kundër të pandehurit F. B. S. duke vendosur sipas inicimit te procedurës se kundërvajtjes nga Policia, kundër të lartcekurit për kundërvajtje te shkaktimit të aksidentit rrugor duke vepruar ne kundërshtim me nenin 249 par.1 e lidhur me neni **255 paragrafi 2** Ligjit Nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut me datë 19.11.2024 mori këtë

## **AKT GJYKIM**

Kundër palës se pandehur: **F. Sh. nga i ati .i** lindur me dt. .... në fshatin **Seqishtë, me vendbanim në rrugën ..... Prishtinë banesat e ....., ku edhe jeton**, i gjendjes së dobët ekonomike ,i pa martuar, i pa dënuar me parë për kundërvajtje, nuk gjendet nen hetime me numër personal 1173801854.shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTORË**

Për shkak se me dt ..... rreth orës 13.30, duke lëvizur në rrugën Lipjan Graqanicë, duke e drejtuar automjetin e tipit Shkoda Oktavia me targa të regjistrimit ....., duke mos i respektuar rregullat për sigurinë e komunikacionit rrugor, duke mos ju përshtatur vozitjen kushteve në rrugës ka shkaktuar vetë aksident në atë mënyrë që gjatë tejkalimit ka humbur kontrollin mbi automjet, dhe e devijon levizjen e automjetit, duke e goditur një mbrojtës së aluminit dhe betonit të firmës Mamusha Comerce.Me atë rast janë shkaktuar dëme të mëdha në automjetin e të pandehurit, si dhe janë dëmtuar mbrojtëset e aluminit dhe betonit të firmës Mamusha Commerce.

Me çka ka kryer kundërvajtje nga nenin 249 par.1 e lidhur me neni **255 paragrafi 2** i Ligjit Nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut, andaj Gjykata, duke vendosur në kuptim të neni e ne bazë të

neneve: nenit 3 paragrafi 3, 7, 8, 9, 27, 1.1, dhe aplikim te nenit 28.2 te Ligjit Nr. 05/L-087 Për Kundërvajtje, të pandehurës i shqipton.

## D E N O H E T

### ME QORTIM

**Obligohet që në emër të taksës së gjykatës të paguaj shumën prej 5€ (pesë) euro**

### A r s y e t i m

Policia e Kosovës- Graqanicë, me shkresën SHQ5A0003855718 e dt. 06.11.2024, në Gjykatë ka bërë kërkesë për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes kundër Faton Baki Shkreta.

Gjykata mori në pyetje, palën e pandehur F. B. Sh., u paraqit në Gjykatë për te dhënë deklaratë ku i njejtë e pranoj kundërvajtjen. Ka kërkuar që gjykata të merr parasysh se ky aksident është shkaktuar nga pakujdesia. Ka deklaruar se dëmi i shkktuar është tejet i madh si në vetur, po ashtu vetëm i pandehuri është lënduar nga ky aksident. Ka kërkuar nga Gjykata që mundësisht ti ja shqiptoj një dënim sa ma të lehtë.

Gjykata pas administrimit te gjitha provave, veç e veç si deklaratën e palës së pandehur inicimin e Policisë sipas vrojtimit te drejtpërdrejt, beri që Gjykata te vërtetoj se vërtetë pala e pandehur është fajtores për kundërvajtjen me te cilën ngarkohet, andaj pasi Gjykata vërtetoj fajësinë e të pandehurit për kundërvajtjen me te cilën ngarkohet, të njëjtit i shqiptoj dënimin sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit mori parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, gjendjen ekonomike, sjelljen e mëparshme, peshën e kundërvajtjes, ku Gjykata beson se shqiptimi i këtij dënimi do te arsyetoi arritjen e qëllimit të shqiptimit të dënimit dhe do të ndikoj qe kryerësi në të ardhmen mos te përsërisë kundërvajtje te njëjte apo te ngjashme me të. Kjo gjykatë dënimin e lartë cekur ia shqiptoj bazuar në neni 28 par.2 të Ligjit për kundërvajtje.

Me sa u tha me lartë u vendos si ne dispozitiv te këtij Aktgjykimi

**U Vendos ne Gjykatën Themelore Prishtinë-DEGA NË GRAQANICË-Divizioni për Kundërvajtje, lënda me numër: K.nr.394/2024 me dt.19.11.2024**

**Gjyqtari  
Rrustem Begolli**

#### **KESHILLA JURIDIKE:**

Të drejtë ankese ka i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës, përmes kësaj Gjykate, Gjykatës se Apelit Prishtinë- Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë ne afat prej 8 ditësh.